RAPORTI IEKSPERTIT SHQYRTUES

Visar BIBAJ / Ekspert Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Data e dorëzimit të raportit	Nr. lëndës:
_____	**19.04.2022**	**28.04.2022**	**100/22**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Më datën: **14.04.2022**, OE DPH "Luzern" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me numër: **100/22**, kundër propozimit për dhënie te kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Shërbime Hoteliere – Bufe e ish bankosit – RI TENDER", me nr. prokurimi: 214-22-526-2-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Punëve te Brendshme".

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës shërbim, vlera e parashikuar: **69 778,20** €

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE SIPAS OE ANKUES

Dispozitat e LPP-se, te shkelura nga AK sipas OE ankues.
NENIN-7,NENI 60,NENI-61,RREGULLAT PER TENDERET JO-NORMALISHT TE ULET

DEKLARATA DETALE E ANKESES

D.P.H. LUZERN KONSIDERON QE AK NE NJOFTIMIN MBI VENDIMIN PER TENDERFN :SHERBIME HOTELIERE -BUFFE PER OBJEKTIN E ISH - BANKOS"ME NR. PROKURIMI 214-22-526-2-2-1,NUK KA RESPEKTUAR NENET E MESIPERME.

DUKE PATUR PARASYSH SI DHE DUKE JU REFERUAR LIGJIT TE PROKURIMIT PUBLIK SI DHE RREGULLAVE TE PERCAKTUARA PER TENDERET JO- NORMALISHT TE ULET, TE QELLIMI I KETYRE RREGULLAVE,AUTORITETI KONTRAKTUES NE PERPUTHJE ME KETO RREGULLA TE JENE EDHE VENDIMETESHTE ME RENDESI TE THEKSOHET SE CMIMET E OFRUARA NGA TENDERUESI 1 SUKSESESHEM NUK PERKOJNE FARE ME CMIMET E TREGUT AS PER SE AFERMI, POR JANE NEN CDO MINIMUM,KJO ESHTE TRASPARENTE DHE E DUKESHME POR SA TI ANALIZOSH CMIMET E OFRUARA NGA KY TENDERUES E QE JANE EKSTREMISHT TE ULETA DHE TE PAREALIZUESHME.

PER T1 ARGUMENTUAR KETO CMIME PO MARRIM DISA SHEMBUJ TE OFRUARA NGA KY

OFERUES:

FILE PULE -200 GRAM FILE PULE ME GARNITUREN PERCJELLESE POMFRIT- ORIZ-PERIME TE FERGUARA ME CMIMFN PREJ 1.50 EURO,KUR DIHET SE SA KUSHTON VETEM KILOGRAMI I FILES SE PULE TANI EDHE ME NJE CMIM ME TE LARTE PERSHKAKE KRIZES EKONOMIKE GLOBALE QE KA SHKAKETUAR INFLACIONIN ME TE MADH GJATE KETYRE 20 VJETEVE.

2.SALLATE SHOPE -200 GRAMESHE KU PRODUKTl BAZE ESHTE DOMATJA DUKE E PERCJELLUR ARTIKUJT TE TJERE SI DJATHI ETJ..KUR DIHET SE NJE KILOGRAM DOMATE TANI KUSHTON DERI NE 2.80 EURO E QE NE KALKULIM PER 100 GRAM KUSHTONE 0.28 CENT PER 200GRAM I BIE 0.56 CENT ,KURSE NE OFERTE ESHTE I MARKUAR ME 0.40 CENT.

3.SALLATE TUNO NE OFERTE ME CMIMIN 0.50 CENT E NE ANEN TJETER KY LLOJ MISHl PESHKU KA RRITJE ENORME DHE CMIMI I TIJE SILLET RRETH PREJ 13 EURO E 70 SHTATEDHJETE CENT,KJO SALLAT PRODUKTIN BAZE E KA MISHIN TONO PREJ 200 GRAMESH NE KALKULIM PER 100 GRAM 1 BIE 1.37 EURO.

4. MAKARONAT BOLONEZ ME SOS KEPURDHASH E SOS DOMATESH KY PREJ 300 GRAMESH ESHTE OFRUAR ME CMIMIB PREJ NJE EURO

5. POASHTU EDHE SHPAGETA ME KETE PERBERJE ME CMIM PREJ NJE EURO 6.

OMLET(PERSHUT 300 GRAM) CMIMI NJE EURO,KUR DIHET SE NJE KG PROSHUT KUSHTON PREJ 8.8 DERI NE 9.4 ME E LIRA.NEQOFTESE KJO ZBERTHET NE 100 GRAM I BJEN QE KUSHTON 100GRAM=0.88 DERI NE 0.94 CENT.

7. KAPUCINO ME OFERTIM 0.20 CENT NE OFERT

8. QUMESHT ME COKOLLAD 0.20 CENT NE OFERT

9. E SHUME ARTIKUJ TE TJERE.

SHTROHET PYETJA SI TE ARSYTOHEN TE GJITHE KETO ARTIKUJ,CMIMET E VENDOSURA JANE JASHT CDO NORMALEJE DHE JO TE REALIZUESHME PER KONTRATEN,SIPAS RREGULLAVE PER TENDERET JO-NORMALISHT TE ULET KY OFRIM I CMIMEVE KRIJON MOS REALIZIM APO MOS PERBUSHJE TE KONTRATES.SE NUK KA SHPJEGIM EDHE AK NE VENDIMIN PER REFUZIM PER RI-SHQYRTIM PER KETO CMIME MUND TE ANALIZONI EDHE JU EKSPERT TE NDERUAR NE VENDIMIN E SAJ.

ANDAJ D.P.H. LUZERN-KERKON NGA OSHP-JA, QE LENDEN E KETIJ TENDERI TA KTHEJ NE RI – VLERESIM.

KRITERET PËR VLERËSIM

NUK KONTESTOHET

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES.

Ska

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

NA

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "Etiani Shpk & Lurn shpk - ISTOG

Sqarim Hyrës: Autoriteti Kontraktues - "Ministria e Punëve te Brendshme", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontratës është shërbim (kornizë 36 muaj) me vlerë të mesme.

Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit per dhënie te kontratës, përkatësisht OE ankues "DPH "Luzern" – Prishtine, me tej si parashtruesi i ankesës konteston ofertën financiare te operatorit ekonomik te rekomanduar per dhënie te kontratës ku pretendohet se i njeti ka ofertuar me pozicione te caktuara si jo normalisht te ulëta.

- Keto pretendime ankimore janë kontestuar edhe ne AK , sipas kërkesës per ri shqyrtim, përderisa AK – MPB, e ka refuzuar kërkesën si te pa bazuar dhe ka lene ne fuqi propozimin per dhënie te kontratës.

Përgjigjeje në pretendimin ankimore 1 (neni 113) : Pas administrimit dhe shqyrtimit te shkresave te lendes kundrejt pretendimeve ankimore sqarojmë se parashtruesi i ankesës përmes deklaratës ne ankese konteston disa nga pozicionet e çmimeve te ofruara nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie te kontratës ku thirret ne krizën aktuale ekonomike dhe ngritjen e çmimeve.
Shembull: , "Kafe – Capuchino" – 0.20 cent; "Qumësht me çokolatë (bambi)" 0.20 cent; "File pule 200 gram me garniture (pomfrit, oriz dhe perime te fërguara)" 1.50 cent etj.

Bazuar ne dispozitat e nenit 61, te LPP-se si dhe rregullat për çmime jo normalisht te ulëta, përcaktohet qe, nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender qe, është ose duket te jote jo-normalisht i ulet, AK do te dërgoi një kërkese me shkrim shpjegim për ofertën apo pozicionet. AK – MPB, pra barra biem mbi autoritetin kontraktues, rrjedhimisht AK - MPB, i ka dhëne arsyetimet e veta tek vendimi i nxjerre

kundrejt kërkesës për ri shqyrtim, dhe ofertat si te tilla i ka trajtuar si te mirëqena. Përveç kësejë AK – MPB , ka vendosur edhe masat e sigurisë për ekzekutimin e kontratës siç është sigurimi i ekzekutimit.
Për me tepër, po t'i referohemi ofertës financiare te parashtruesit te ankesës, rezulton qe i njëjti ka ofertuar me çmim te njëjte për pozicion te cilat i kontestohen operatorit ekonomik te rekomanduar për dhënie te kontratës, siç janë : "Kafe – Capuchino" dhe "Qumësht me çokollatë (Bambi)", (me 0.20 cent ka ofertuar edhe OE ankues) prandaj pretendimet ankimore te parashtruesit te ankesës i kualifikojmë si te pa bazuara.

Si prove se bashku me raport gjeni kopjet:
Pjese nga para masa e OE ankues dhe atij te rekomanduar për dhënie te kontratës.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, DPH "Luzern"- Prishtine, të refuzohet si e pa bazuar dhe ti lejohet AK-se te procedoj tutje me procedure te prokurimit bazuar ne dispozita te LPP-se.

Raporti ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – DPH "Luzern"- Prishtine
- Panelit Shqyrtues – OSHP.
- OE ankues - Ministria e Punëve te Brendshme.